



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:024513

Datë: 20.08.2024

Numri i dokumentit: 06068166

C.nr.106/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Awni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses H.D nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson D.M, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 580.16 euro, jashtë seance, më datën 20.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses H.D.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses H.D nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar – Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 22.01.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses H.D, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 537.19 euro e deri në shumën 580.16 euro, dhe atë në shumën prej 42.97 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses H.D ti paguaj shumën prej 125.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja H.D nga Rahoveci, në këtë gjykatë me datë 22.01.2024, përmes të autorizuarit të saj D.M, avokat në Prizren, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është në mardhënie pune si mësimdhënëse në SH.F.M.U. “Bajram Curri” në fshatin Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, duke llogaritur prej hyrjes në fuqi të Kontratës ,paditëses

i ka takur e drejta e kompensimit për shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, në bazë të nivelit të shkallës së inflacionit ndër vite, kjo duke u bazuar në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 por që deri më tani nuk është kompensuar. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 03.07.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Kërkesëpadinë e paditëses e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësja ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 22.01.2024, andaj konsideron që kërkesëpadia e paditëses është parashkruar në tërsi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shume se 3 vite.

Ka theksuar që paditësja H.D, pranë kësaj gjykate, me datë 21.09.2023, ka parashtruar padi tjetër në emër të inflacionit vjetor me numër C.nr.829/2023, me numër të lëndës 2023:203207, për periudhën kohore 01.01.2020-21.11.2022, andaj e kontestojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për kompensim në emër të inflacionit vjetor për vitin 2022, ashtu që i ka propozuar gjykatës që padinë e paditëses ta hedh poshtë si të palejuar për shkak të gjyqëvarësisë-litispëndencës, konform nenit 391 pika c) të LPK-së.

Paditësja me padi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të inflacionit me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë, të cilën e konteston në tërësi, sepse konsideron se kamata duhet të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, respektivisht nga dita kur paditësve u njihet e drejta e kompensimit, kur edhe e paditura kuton në bazë të aktgjykimit lidhur me detyrimet financiare që i ka ndaj paditësve.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SH.F.M.U “Bajram Curri”, në fshatin Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumën prej

421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses H.D, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 12.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vlerëson se baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore nuk është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 22.01.2024.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata për këtë çështje ka vlerësuar se si moment/periudhë e rrjedhës së kamatës për kërkesat regresuese të kreditorit, duhet të merret data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit tek debitori (data e pranimit të kërkesës nga ana e debitorit), apo data e parashtrimit të padisë në gjykatë për rastet kur kreditori nuk ka paraqitur paraprakisht një kërkesë të tillë tek debitori. LMD me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 ka përcaktuar detyrimin e pagesës së kamatëvonesës: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe*

kamatën”, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Në rastin konkret, duke qenë se debitori vetëm në momentin e pranimin të padisë nga gjykata është njohur me përmbajtjen e detyrimit për pagesën e kërkesës regresuese të kreditorit, gjykata si moment të rrjedhjes së kamatës së kreditorit ka marrë datën 22.01.2024, kur është parashtruar padia dhe mbi këtë bazë ka refuzuar shumën prej 42.97 euro, si shumë e kamatës vjetore, e cila ishte paraqitur bashkë me kërkesën kryesore si vlerë e përgjithshme.

Sa i përket pretendimeve të paditurës se paditësja H.D, pranë kësaj gjykate, me datë 21.09.2023, ka parashtruar padi tjetër në emër të inflacionit vjetor me numër C.nr.829/2023, me numër të lëndës 2023:203207, për periudhën kohore 01.01.2020-21.11.2022, gjykata ka vërtetuar faktin që me datën 11.07.2024 gjykata ka marrë AKTVENDIM me të cilin e ka konsideruar si të tërhequr padinë, pasi që përfaqësuesi i autorizuar i paditëses me parashtrësë të veçantë e ka tërhequr padinë.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e

shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.106/2024, më datën 20.08.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.